



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 483

Lënda: Praktika profesionale në Pediatri

PROGRAMI I LËNDËS									
Praktika profesionale në Pediatri									
Titullari i lëndës:		Rezarta Lalo <i>Dr në Shkencat Infermierore</i>							
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	6 ECTS	0	0	0	150	0	150	0	150
Tipologjia e lëndës		Lëndë plotësuese							
Viti/akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II							
Lloji i lëndës		E detyruar							
Programi i studimit		Master profesional Infermieri Pediatrike							
Kodi i lëndës		INF 483							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		rezarta.petani@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	<p>Praktika infermierore në patologjitë pediatrike është guri i themelit në formimin e Infermierit Peditër të profesionalizuar. Ajo u jep mundësinë infermierëve që ndjekin këtë program studimi të aplikojnë dhe përfeksionojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara paraprkisht gjatë semestrit të parë të këtij programi mësimor. Studentët do të aftësohen në arsyetimin klinik dhe do të zhvillojnë kapacitete në vlerësimin dhe menaxhimin e pacientëve nëpërmjet marrjes në ngarkim të kujdesit infermieror të pacientëve pediatrikë. Duke punuar së bashku me stafin infermieror të reparteve të ndryshme të pediatriisë dhe pedagogët mbikëqyrës, studentët do të fitojnë vet-besimin e duhur për të punuar në mënyrë të pavarur si hartues, menaxhues dhe koordinatorë të kujdesit shëndetsor pediatrik.</p>
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">▪ Të kontrollojnë mjedisin termal nëpërmjet operimit me pajisjet e duhura për të minimizuar humbjet e temperaturës dhe kontrollit të saj tek foshnjat e porsalindura.▪ Të identifikojnë ndryshimet në parametrat vitale dhe të realizojnë matjen dhe kontrollin e tyre tek foshnjat e porsalindura dhe fëmijët pediatrike.▪ Të njohin teknikat e ekzaminimeve të ndryshme screening (gjak, urinë, kultura të ndryshme) tek foshnjat e porsalindura dhe fëmijët pediatrike.▪ Të njohin dhe realizojnë teknikat e administrimit të terapisë sipas përshkrimit të mjekut në rrugë të ndryshme si inserimi dhe menaxhimi i infuzioneve pëifeerike intravenoze, muskulare, kutane, subcutane, përdorimit të katetereve umbilikale etj.▪ Të administrojnë dhe monitorojnë oksigjenimin e foshnjave dhe fëmijëve pediatrike duke operuar me pajisjet e duhura.▪ Të njohin dhe zbatojnë teknikat reanimatore tek foshnjat dhe teknikat PVD tek fëmijët me probleme respiratore.▪ Të aplikojnë teknikat e ushqyerjes të foshnjave normale dhe në risk.▪ Të implementojnë planet e kujdesit dhe ndërhyrjet e duhura emergjente sipas hallkave të procesit infermieror për probleme shëndetësore të sistemeve të ndryshme të organizmit.



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETTIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETTËSOR

	<ul style="list-style-type: none"> Të zbatojnë strategjitë e parandalimit të përhapjes së infeksionit në pediatri, rëndësinë e përdorimit të duhur të antibiotikëve dhe teknikat e administrimit të tyre.
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të aplikojnë dhe kryejnë ekzaktësisht teknikat infermiere të administrimit të medikamenteve në rrugë të ndryshme duke respektuar dozat e përshkruara dhe mënyrën e përgatitjes para inserimit të tyre. Të operojnë me pajisjet e duhura për shpërndarjen e kontrolluar të oksigjenit, të operojnë me radiantët, inkubatorët për të kontrolluar mjedisin termal neutral, të operojnë me pajisjen e fototerapisë për kontrollin e ikerit patologjik, të operojnë me pajisjet e monitorimit të parametrave vitale si tokokardiografi, pulsoksimetri etj Të marrin për ekzaminim screening kultura të ndryshme me qëllim diagnostikues, të realizojnë teste laboratorike dhe instrumentare tek foshnjat dhe fëmijët e moshave pediatrike. Të identifikojnë problemet e ushqyerjes me gjë tek foshnjat, të realizojnë teknikat e ushqyerjes me tub dhe alternative, të implementojnë terapitë dietetike në probleme të ndryshme shëndetësore për moshat pediatrike. Të realizojnë ndërhyrjet e planifikuara për problemet e shëndetit të fëmijës që prekin të gjitha sistemet e organizmit duke përfshirë edukimin shëndetësor me impakt në parandalimin e tyre.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE							
FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive e studentit në praktikën profesionale. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>						
KONTROLLI VAZHDUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>	
	Vlerësim nga Shefi i Pavionit të Pediatrisë	Fundi i semestrit	Performanca gjatë qëndrimit në pavion	Kalon/s'kalon	Vlerësimi i performancës në praktikë	Korrektësia dhe përkushtimi në realizimin e detyrave	
	Provimi final	Fundi i semestrit	Proçedura infermiere	100 pikë	Demonstrim proçedurash infermiere me mulazhe dhe pacientë konkretë	Proçedura infermiere	
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto prirshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Institucioneve shëndetësore, përgjegjshmërinë gjatë procesit të praktikës profesionale, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në praktikën profesionale nuk do të tolerohen.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura spitalore dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje dhe angazhim gjatë procesit të praktikës profesionale, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë institucionit spitalor. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Gjatë realizimit të provimit të praktikës profesionale nuk duhet të komunikohet dhe të kopjohet.